



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni vjeshtor**

Kryesia e Kuvendit  
P-045  
Prishtinë, më 23 dhjetor 2008, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 23 DHJETOR 2008

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa munguan: Nexhat Daci, Ibrahim Gashi dhe Xhezair Murati.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini dhe Mufera Sinik, ndërsa munguan: Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviç.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skender Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Ismet Hajrullahu; dhe

Nga OSBE: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Vizita e delegacionit të Kuvendit në Turqi,
3. Çështja e organizimit të një konference për gazetarët, që i kanë përcjellë punimet e Kuvendit gjatë vitit 2008, dhe
4. Shqyrtimi i kërkesës së këshilltarit të Kryetarit.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 dhjetor 2008**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 dhjetor 2008, u miratua pa vërejtje.

Sabri Hamiti pati vërejtje në transkript se janë evidencuar edhe diskutimit që kanë qenë pa kyçje të mikrofonit.

#### **2. Vizita e delegacionit të Kuvendit në Turqi**

Me propozim të kryetarit, Kryesia vendosi që delegacioni i Kuvendit, në përbërje: Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit, Haliti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Xhezair Murati, deputeti Mahir Yagcilar, shefi i Kabinetit të Kryetarit, Mehmet Hajrizi, sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, shefi i Protokollit, Skender Reçica, si dhe zyrtari për siguri të Kryetarit, Agron Krasniqi, ta vizitojë Parlamentin e Turqisë prej 5 deri me 9 janar 2009.

#### **3. Organizimi i një konference për gazetarët, që i kanë përcjellë punimet e Kuvendit gjatë vitit 2008**

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që më 24 dhjetor 2008, në orën 12:00, në Vilën “Gërmia”, të organizohet një Konferencë për media për të pasqyruar punimet e Kuvendit gjatë vitit 2008, si dhe për të shtruar një drekë për gazetarët që i kanë përcjellë punimet e Kuvendit gjatë këtij viti.

Në këtë takim do të merrnin pjesë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare.

#### **4. Shqyrtimi i kërkesës së këshilltarit Kryetarit**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

Miratohet kërkesa e këshilltarit të Kryetarit, Basri Musmurati, për kompensimin e një pjese të shpenzimeve me rastin e operacionit në zemër, në spitalin amerikan në Tiranë, në shumën prej pesëmijë (5.000) €.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**